



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 944/2 prot.,

Datë 04.05.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Curri” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-58077-02-06-2023, me objekt: “*Rikualifikimi urban i zonës “Kodra e Diellit” - Faza I*” me fond limit 264,189,003.3 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.02.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Ankimues: “Curri” SHPK.
Rr. “Kajo Karafili”, Nd.2, H., Ap.3, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Tiranë
Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Në datën 03.05.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 944 protokolli e operatorit ekonomik “Curri” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-58077-02-06-2023, me objekt: “*Rikualifikimi urban i zonës “Kodra e Diellit” - Faza I*” me fond limit 264,189,003.3 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.02.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Curri” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Curri” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 944 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Operatori ekonomik Curri shpk, nuk ploteson piken 8/8.2, te Kriterete te Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik ku percaktohet se: “Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit teknik ndertimi, elektrikist dhe hidraulik, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka leshuar këte dokument”, pasi nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimit rezulton se operatori ekonomik Curri shpk, nuk ka deklaruar për punonjesit teknik ndertimi, elektrikist dhe hidraulik, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka leshuar këte document. Operatori ekonomik Curri shpk, nuk ploteson piken 8/8.4, te Kriterete te Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik ku percaktohet se: “Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit eskavatoriste, automakinist dhe buldozeriste, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, si dhe numrin e deshmise së aftësisë profesionale”, pasi nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimit rezulton se operatori ekonomik Curri shpk, nuk ka deklaruar për punonjesit eskavatoriste, automakinist dhe buldozeriste, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, si dhe numrin e deshmise së aftësisë profesionale. Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk përmbush kërkesat e percaktuara në piken 13, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, në DST, ku percaktohet: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)”. Nga verifikimi formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në shtojcën e makinerive rezulton se operatori ekonomik “Curri” Shpk se ka deklaruar 3 (tre) Eskavator me goma, por vetëm 2 (dy) plotesojnë DST, pasi për 1 (një) Eskavator me goma nuk ka deklaruar Targat, Numerin e Lejes së Qarkullimit, cka bie në kundërshtim me kërkesat për plotesimin dhe deklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk përmbush kërkesat e percaktuara në piken 13, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, në DST, ku percaktohet: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)”. Nga verifikimi formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në shtojcën e makinerive rezulton se operatori ekonomik “Curri” Shpk se ka deklaruar 3 (tre) Fadrome me goma, por vetëm 2 (dy) plotesojnë DST, pasi për 1 (një) Fadrome

me goma, nuk ka deklaruar Targat, Numerin e Lejes se Qarkullimit, cka bie ne kundërshtim me kërkesat për plotësimin dhe deklarimet në formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk përmbush Kriteret e Përgjithëshme të Kualifikimit, ku përcaktohet se: “Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8”. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetedeklarimit, i paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezulton se operatori ekonomik “Curri” Shpk nuk ka paraqitur formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimeve në Dokumentet Standarte të Tenderit për këtë procedurë prokurimi. Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk përmbush Kriteret e Përgjithëshme të Kualifikimit, ku përcaktohet se: “Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8”. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetedeklarimit, i paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezulton se operatori ekonomik “Curri” Shpk, në Deklaratën B, pika 7 është plotësuar gabim.”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 04.05.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova